



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2123/3Prot

Datë 01.11.2021

VENDIM

K.P.P. 834/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Jonaïd Myzyri | Kryetar |
| Fiovent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 01.11.2021, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Hydro-Eng Consulting” SHPK në procedurën e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Mbikëqyrje punimesh ne objektin: “Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë”, me nr. REF-06885-09-30-2021, me fond limit 2,408,038.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Hydro-Eng Consulting” SHPK
Rruga “Ahmet Ramzoti”, Lagjja nr.18, 2001 Durrës
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Rrogozhinë
Lagjja Nr.1, Rruga e Kavajës
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Ligji nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 42 e vijues”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e

rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe ligji nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 42 e vijues.

I.3. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.10.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit*”, me objekt “*Mbikëqyrje punimesh ne objektin: “Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë*”, me nr. REF-06885-09-30-2021, me fond limit 2,408,038.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.

II.2. Në datën 11.10.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë (shprehje interesi) të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 22.10.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (short listing) ku rezulton si më poshtë vijon:

| | |
|-----------------------------------|----------------|
| - Novatech Studio | I kualifikuar |
| - BOE Lead Consulting&KKG project | I kualifikuar |
| - He&Sk | I skualifikuar |
| - Hydro Eng Consulting&Invictus | I skualifikuar |

II.4. Në datën 29.10.2021, operatori ekonomik ankimues “ Hydro Eng Consulting” ShPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 29.10.2021, autoriteti kontraktor me anë të postës elektronike, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik infomacionin/dokumentacionin lidhur me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Hydro Eng Consulting SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij në fazën e parë të procedurës së prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Mbikëqyrje punimesh ne objektin: “Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë”, me nr. REF-06885-09-30-2021, me fond limit 2,408,038.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 01.10.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Mbikëqyrje punimesh ne objektin: “Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë”, me nr. REF-06885-09-30-2021, me fond limit 2,408,038.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.

III.1.2. Në datën 11.10.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë (shprehje interesi) të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 22.10.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (short listing) ku rezulton si më poshtë vijon:

| | |
|-----------------------------------|----------------|
| - Novatech Studio | I kualifikuar |
| - BOE Lead Consulting&KKG project | I kualifikuar |
| - He&Sk | I skualifikuar |
| - Hydro Eng Consulting&Invictus | I skualifikuar |

III.1.4. Në datën 29.10.2021, operatori ekonomik ankimues “Hydro Eng Consulting” ShPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.5. Në datën 29.10.2021, autoriteti kontraktor me anë të postës elektronike, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik infomacionin/dokumentacionin lidhur me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.1.6. Neni 42 pika 10 i ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, parashikohet shprehimisht se: *“Pas afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët brenda 10 ditëve kalendarike. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankim administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues. KPP-ja shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe të këtij akti. Për efekt kohe, komunikimi midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor bëhet nëpërmjet e-mail-it zyrtar. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.”*

III.1.7. Neni 60 “Verifikimi i kushteve formale” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, parashikon shprehimisht se: *Komisioni zhvillon mbledhjen për shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se ditën pasardhëse të punës nga data e regjistrimit të ankesës, në të cilën verifikon:*

- a) juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;*
- b) legjitimitimin e ankuesit;*
- c) respektimin e afateve ligjore për ankimin;*
- d) elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në pikën 2 të nenit 48 të kësaj rregulloreje.*

3. Komisioni voton sipas mënyrës së përcaktuar në Kreun IV të kësaj rregulloreje dhe vendos:

a) Mospranimin e ankesës për shkak të mungesës së kushteve formale të saj, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Në këtë rast, Komisioni ia njofton vendimin ankimuesit, si dhe autoritetit kontraktues me qëllim, që ky i fundit të marrë masat për vazhdimin e procedurës konkurruese nëse e ka pezulluar atë;

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurat e prokurimit të përshpejtuara në kuadër të rindërtimit, në rastin e vendimit për përzgjedhjen e kandidatëve, **bëhet brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues.** Në rastin konkret rezulton, se autoriteti kontraktor ka përfunduar procesin e vlerësimit lidhur me fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt-ankimi më datë 22.10.2021. Ndërkohë ankesa e operatorit ekonomik ankimues Hydro Eng Consulting” ShPK është paraqitur pranë KPP-së më datë 29.10.2021, përtej afatit 3 ditor të parashikuar në ligj. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues pranë KPP në datën 29.10.2021, lidhur me kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij për fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk janë brenda afateve ligjore të ankimit, sikurse parashikohet në ligjin e sipërcituar, çka rrjedhimisht sjell si pasojë mospërmbushjen nga ana e ankimuesit të detyrimit për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të

parashikuar nga ligji nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Hydro Eng Consulting SHPK nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 42 i ligjit nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 60 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Hydro Eng Consulting” SHPK për procedurën e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Mbikëqyrje punimesh ne objektin: “Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë”, me nr. REF-06885-09-30-2021, me fond limit 2,408,038.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Hydro Eng Consulting” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri